



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.09.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:07 dhe mbaroi në orën 11:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 3. Medi Bici (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ilir Toska (anëtar)*
- 8. Alban Toro (anëtar)*
- 9. Brikena Ukperaj (anëtar)*
- 10. Erjon Muharremaj (anëtar)*
- 11. Marçela Shehu (anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

4. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.

5. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Mbledhja fillon me fjalën hyrëse të Kryetares së Këshillit e cila shprehet se në rendin e ditës do të merret për shqyrtim një çështje e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska fillimisht propozon mbi radhën e hedhjes së shortit sipas këtyre gjykatave: Fillimisht hidhet shorti për: 1. Gjykatat apelit të juridiksionit të përgjithshëm: Gjykata e Apelit Korçë, Gjykata e Apelit Shkodër, Gjykata e Apelit Gjirokastrë, Gjykata e Apelit Vlorë, Gjykata e Apelit Durrës; 2. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; 3. Gjykata Administrative e Apelit; 4. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat; 5. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë; 6. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës; 7. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; 8. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Pogradec; 9. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës, për: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan; 10. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, sipas kësaj radhe: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë.

Pasi anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e zotit Toska për radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 11 çështje gjyqësore, 8 në lëndë penale dhe 3 në lëndë civile, çështje të karakterit tepër urgjent ose urgjent.

Kërkesa e Gjykatës së Apelit Korçë për çështjen nr.1 është bërë më datë 29.01.2020, në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë Vendimin nr.74, datë 20.02.2020, “Për Komandimin e gjyqtarës znj.{...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një afat 2-vjeçar”, si dhe Vendimin nr.75, datë 20.02.2020, me të cilin “Gjyqtarja e skemës së delegimit znj.{...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më datë 15.09.2020”.

Për rrjedhojë, nevoja e Gjykatës së Apelit Korçë për çështjen nr.1 aktualisht ekziston në një masë më të vogël, pra për një gjyqtar më pak, domethënë për 2 (dy) gjyqtarë, çka do të mbahet parasysh më poshtë në rastin e trajtimit të kësaj kërkesë.

Kërkesa e Gjykatës së Apelit Korçë për çështjen nr.10 është bërë më datë 16.07.2020, ndërkohë që me një kërkesë të datës 23.07.2020, gjykata ka njoftuar se: “... Pas kërkesës për përjashtim gjyqtari janë marrë dhe vlerësuar nga anëtarët e trupit gjykues vendimet e dhëna me parë, ndaj të njëjtave palë dhe është vlerësuar të hiqet dorë nga gjykimi i çështjes. Në këto kushte kërkesa për delegim të gjyqtarëve mbetet pa objekt”.

Në këto kushte, kërkesa e Gjykatës së Apelit Korçë për çështjen nr.10 tashmë ka mbetur pa objekt, prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Kod rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga Ligji nr.115/2016 “Për

organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse përcakton neni 97/3 i tij.

Nisur nga rrethanat si më lart, sa i përket kërkesës së Gjykatës së Apelit Korçë për çështjen nr.10, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosi: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të Kërkesës nr.771 prot., datë 16.07.2020, që u përket palëve: paditës: {...}, {...}; të paditur: {...}, {...}, {...}; objekti: “Detyrim njohje bashkëpronar” (objekti i shqyrtimit: “Kërkesa për përjashtim”).

Propozimet vijuese të Komisionit me tej janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre 10 çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 10 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese janë:

Për 10 çështje, ato nr.1-9 dhe nr.11, për të cilat kërkohet nga 1, 2 dhe 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, që janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Apelit Korçë, konkretisht nga gjyqtarët Genti Shala, Shkëlqim Mustafa dhe Valdete Hoxha. Në këtë rast, për çështjen nr.11, me short, caktohet dhe relatori.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjes nr.3 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: z.Genti Shala; Në shortimin e çështjeve nr.4 dhe nr.5 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë që është caktuar më herët për gjykimin e tyre, konkretisht: z.Shkëlqim Mustafa; Në shortimin e çështjes nr.8 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: znj.Valdete Hoxha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Genti Shala.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtari Genti Shala.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Për çështjen nr. 9, civile, gjyqtari Shkëlqim Mustafa.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarja Valdete Hoxha.

Për çështjen nr. 11, civile, gjyqtarët Genti Shala (relator), Shkëlqim Mustafa dhe Valdete Hoxha (anëtarë).

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtari Genti Shala.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Shkëlqim Mustafa dhe Valdete Hoxha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 18 çështje gjyqësore, 3 në lëndë civile dhe 15 në lëndë penale, me karakter tepër urgjent ose urgjent.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 18 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë Gjykata e Apelit Durrës, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 11 (4 nga Gjykata e Apelit Durrës, 4 nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe 3 nga Gjykata e Apelit Tiranë).

Për 7 çështje penale, ato nr.4, nr.5, nr.6, nr.7, nr.16, nr.17 dhe nr.18, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës.

Për 6 çështje penale, ato nr.8, nr.9, nr.10, nr.13, nr.14 dhe nr.15, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për 5 çështje civile dhe penale, ato nr.1, nr.2, nr.3, nr.11 dhe nr.12, për të cilat kërkohen 1 dhe 2 gjyqtarë, të caktohen 3 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetarët në detyrë të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Znj.Nertina Kosova, Z.Ridvan Hado. Të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilës i është akorduar leje afatgjatë nga ish-KLD-ja, leje që ka përfunduar (më datë 01.04.2020), por që nga gjykata nuk ka ndonjë njoftim për kthimin e saj në detyrë, konkretisht: znj.Evjeni Sinojmeri. Të përjashtohen gjithashtu edhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilët janë në proces rivlerësimi kalimtar dhe është publikuar data e seancës dëgjimore, konkretisht: z.Tritan Hamitaj; z.Artur Gaxha. Më tej të përjashtohen nga shorti 3 gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që do të caktohen për gjykimin e çështjeve të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, që rezultuan Genti Shala, Shkëlqim Mustafa dhe Valdete Hoxha. Në shortimin e çështjes penale nr. 4 të përjashtohen nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: znj.Anita Mici.

Ndërsa në shortimin e çështjes, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i saj, konkretisht: z.Desart Avdulaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 17, penale, gjyqtarët Anita Mici dhe Valbon Çekrezi.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Desart Avdulaj.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarja Anita Mici.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtari Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 16, penale, gjyqtarët Valbon Çekrezi dhe Desart Avdulaj.

Për çështjen nr. 18, penale, gjyqtarët Anita Mici dhe Izet Dushaj.

Për çështjen nr. 15, penale, gjyqtarët Dhimitër Lara dhe Sokol Binaj.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtari Saida Dollani.

Për çështjen nr. 10 penale, gjyqtari Dhimitër Lara.

Për çështjen nr.13, penale, gjyqtarët Sokol Binaj dhe Albana Boksi.

Për çështjen nr. 14, penale, gjyqtarët Saida Dollani dhe Dhimitër Lara.

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarja Albana Boksi.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarët Zegjine Sollaku dhe Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarja Elona Toro.

Për çështjen nr. 11, penale, gjyqtarët Zegjine Sollaku dhe Elbana Lluri.

Për çështjen nr. 12, penale, gjyqtarët Elona Toro dhe Zegjine Sollaku.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Elbana Lluri.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 11 çështje gjyqësore, 4 në lëndë civile dhe 7 në lëndë penale, me karakter “tepër urgjent” ose “urgjent”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre 11 çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 11 çështjeve gjyqësore të veçanta të jetë 5.

Për 11 çështje, për të cilat kërkohen 1 dhe 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë. Në këtë rast, për çështjen nr.11, me short, caktohet dhe relatori.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: znj. Ilirija Bezati; Në shortimin çështjeve nr.1 dhe nr.9 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë që është caktuar më herët për gjykimin e tyre, konkretisht: z. Sokol Ngresi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarja Skënder Damini.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Nazmi Troka.

Për çështjen nr. 10 penale, gjyqtarja Klodiana Gjyzari.
Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarja Margarita Buhali.
Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtari Sokol Ngresi.
Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtari Skënder Damini.
Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtari Nazmi Troka.
Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarja Klodiana Gjyzari.
Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarja Margarita Buhali.
Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Sokol Ngresi.
Për çështjen nr.11, penale, gjyqtarët Skënder Damini (relator), Nazmi Troka dhe Klodiana Gjyzari (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë** ka paraqitur nevojë për 10 çështje gjyqësore, 6 në lëndë penale, dhe 4 në lëndë civile, me karakter tepër urgjent ose urgjent.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre 10 çështjeje gjyqësore, të jenë Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe numri i gjyqtarëve të jetë 6.

Për 9 çështje penale dhe civile, ato nr.2-10, për të cilat kërkohen 1, 2 dhe 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Në këtë rast, për çështjet nr.5 dhe nr.6, me short, caktohet dhe relatori, i cili nuk duhet të jetë i njëjti gjyqtar.

Për çështjen penale nr.1, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjes nr.1 të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: znj.Nertina Kosova; Në shortimin e çështjes nr.8 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i

Gjykatës së Apelit Gjirokastër që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: z. Enton Dhimitri; Në shortimin e çështjes nr.10 të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastër që janë caktuar më herët apo kanë pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Z. Dritan Banushi, Znj. Irena Brahimi, Z. Izet Salaj; si dhe si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, të mos përjashtohet nga shorti kryetari i kësaj gjykate, konkretisht: z. Dritan Banushi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 10, civile, gjyqtarët Miranda Andoni dhe Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 8, civile, gjyqtarja Irena Brahimi.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarët Izet Salaj (relator), Dritan Banushi dhe Irena Brahimi (anëtarë).

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Miranda Andoni dhe Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Izet Salaj dhe Dritan Banushi.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Miranda Andoni (relatore), Irena Brahimi dhe Enton Dhimitri (anëtarë).

Për çështjen nr. 7, civile, gjyqtari Izet Salaj.

Për çështjen nr. 9, civile, gjyqtarët Dritan Banushi dhe Irena Brahimi.

Për çështjen nr. 4 penale, gjyqtarët Miranda Andoni dhe Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Dhimitër Lara.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës** ka paraqitur nevojë për 11 çështje gjyqësore, 4 në lëndë civile dhe 7 në lëndë penale që kanë karakter tepër urgjent ose urgjent.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjykata e

Apelit Korçë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 5 (3 nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe 2 nga Gjykata e Apelit Korçë).

Për 7 çështje, ato nr.1, nr.2, nr.5, nr.6, nr.9, nr.10 dhe nr.11, për të cilat kërkohen 1, 2 dhe 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër. Në këtë rast, për çështjet nr.5 dhe nr.6, me short, caktohet dhe relatori, i cili nuk duhet të jetë i njëjti gjyqtar.

Për 4 çështje, ato nr.3, nr.4, nr.7 dhe nr.8, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, të caktohen 2 të tillë, të cilët, për secilën nga ato, të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Korçë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjeve nr.1 dhe nr.2 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër që është caktuar më herët për gjykimin e tyre, konkretisht: znj.Vojsava Osmanaj; Në shortimin e çështjes nr.10 të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: znj.Valbona Vata; Në shortimin e çështjes nr.11 të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër që janë caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: znj.Valbona Vata dhe znj.Vojsava Osmanaj; Në shortimin e çështjeve nr.3, nr.4, nr.7 dhe nr.8 të mos përfshihet në short gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar në Gjykatën e Apelit Korçë, e cila ka ende për gjykim çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, konkretisht: znj.Mimoza Margjeka; si dhe si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër, të mos përjashtohen nga shorti kryetarët në detyrë të këtyre gjyqateve, konkretisht: z. Astrit Kalaja dhe znj. Etleva Temo.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 11, penale, gjyqtari Astrit Kalaja.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Valbona Vata.

Për çështjen nr. 10, penale, gjyqtarët Vojsava Osmanaj dhe Astrit Kalaja.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarja Valbona Vata.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtaët Vojsava Osmanaj (relatore), Astrit Kalaja dhe

Valbona Vata (anëtarë).

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Astrit Kalaja (relator), Vojsava Osmanaj dhe Valbona Vata (anëtarë).

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtari Olsi Xhavella.

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtarja Etleva Temo.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtari Olsi Xhavella.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarja Etleva Temo.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore për përjashtimin e trupit gjykues.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jenë gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1. Gjyqtarët të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, që është në përbërje të trupit gjykues në çështjen e themelit kundër kallzuesve, ndërkohë që çështjet në shqyrtim lidhen me ankimin e kallzuesve ndaj vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal të bërë kundër gjyqtarëve të veçantë të përfshirë në gjykimin e çështjes së themelit kundër tyre, konkretisht: z. Artur Kalaja. Po kështu të përjashtohen nga shorti Kryetarët në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, konkretisht: z. Ridvan Hado, z. Astrit Kalaja, z. Dritan Banushi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Irena Brahimi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Apelit** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore në lëndë administrative.

Kërkesat si më lart të Gjykatës Administrative të Apelit janë bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë Vendimin nr.266, datë 30.07.2020, për “Caktimin në pozicion të gjyqtarit z.{...} pranë Gjykatës Administrative të Apelit”.

Për rrjedhojë, nevojat sipas 3 kërkesave si më lart të Gjykatës Administrative të Apelit aktualisht nuk ekzistojnë më, pasi nevoja për caktimin e 1 gjyqtari në çështjet respektive plotësohet përmes caktimit në pozicion në këtë gjykatë të gjyqtarit {...}.

Në këto kushte, 3 kërkesat si më lart të Gjykatës Administrative të Apelit tashmë kanë mbetur pa objekt, prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenet 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, Kod rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse përcakton neni 97/3 i tij.

Nisur nga rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës Administrative të Apelit, për caktimin e një gjyqtari, për të tre kërkesat e Gjykatës Administrative të Apelit: 1) me objekti: “Shfuqizimi pjesërisht i VKM nr.89, datë 03.06.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së pronës në Republikën e Shqipërisë”, për sa i përket vlerës së pronës kadastrale 8360”; 2) me objekt: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”; 3) me objekti: “Kërkesë për përjashtim gjyqtari”.

(Anëtarët e Këshillit bien dakord me propozimin e Komisionit.)

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, ndërsa numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 4.

Për 2 çështje, ato nr.2 dhe nr.4, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, për secilën nga ato ai të përzgjidhet, me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Për 3 çështje, ato nr.1, nr.3 dhe nr.5, për të cilat kërkohet nga 1 dhe 2 gjyqtarë, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhen, me short, nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjes nr.2 të përjashtohen nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat që është caktuar më parë për gjykimin e saj, konkretisht: z. Murat Lleshi; Në shortimin e çështjes nr.4 të përjashtohen nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat që është caktuar më parë për gjykimin e saj, konkretisht: z. Rexhep Karaj; Në shortimin e çështjeve nr.1, nr.3 dhe nr.5 të përjashtohet nga shorti Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, konkretisht: znj. Alma Kolgjoka.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Rexhep Karaj.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Murat Lleshi.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Enkeleida Hoxha.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarja Engjellushe Tahiri.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Elisabeta Gjoni dhe Enkeleida Hoxha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 4.

Për çështjen nr.1, për të cilën kërkohen 2 gjyqtarë, të caktohen dy gjyqtarë të Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët kanë gjykuar çështjen në themel, vendim i dhënë për të cilën kërkohet ndreqja e gabimit material, konkretisht gjyqtarët Kujtim Vraniçi dhe Bedri Qori.

Për çështjen nr.2, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Për çështjet nr.3 dhe nr.4, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, për secilën nga ato ai të përzgjidhet nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjeve nr.3 dhe nr.4 të përjashtohen nga shorti: Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Znj. Alma Kolgjoka; Dy gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë që do të caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër; Në shortimin e çështjes nr.2 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: z.Murat Lleshi si dhe si përjashtim nga rregulli, në shortimin e çështjeve 3 dhe 4, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i kësaj gjykate, konkretisht: z.Murat Lleshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Kujtim Vraniçi dhe Bedri Qori (sipas relacionit).

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Rexhep Karaj.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Murat Lleshi.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Rexhep Karaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, konkretisht: z. Edvan Veçani, si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër që është me leje lindje, konkretisht: znj. Nerila Kape.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Ardit Kuka.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Xhevdet Lika.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Ardit Kuka.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të njëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat** ka paraqitur nevojë për 6 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2 dhe të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht: Z. Petrit Çomo; Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal për Çështjet e Themelit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët, në vitin 2020, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, në 2 po më shumë çështje gjyqësore, konkretisht: znj.Vjollca Spahiu; z.Kastriot Gramshi; z.Bedri Qori; z.Kreshnik Omari; z.Ahmet Metaliaj; z.Arben Mickaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Sokol Pasho dhe Gerd Hoxha.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Sokol Pasho.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtari Gerd Hoxha.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Sokol Pasho.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtari Gerd Hoxha.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Sokol Pasho.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dymbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe numri i gjyqtarëve të jetë të jetë 3.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, konkretisht: z. Sokol Pina.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Shkëlzen Liçaj.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Suela Xhani (relatore), Enkeleda Doda dhe Shkëlzen Liçaj (anëtarë).

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Suela Xhani.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të trembëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Propozohet që si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, të mos përjashtohen nga shorti kryetari në detyrë të kësaj gjykate, konkretisht: z. Dritan Hasani.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, penale, gjyqtarja Yrfete Shkreli.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore, 2 në lëndë penale dhe 2 në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të për zgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, konkretisht: Z. Arben Dosti.

Në shortimin e çështjeve civile nr.3 dhe nr.4 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjrokastrë që ka pengesë ligjore për gjykimin e tyre, konkretisht: Z. Pëllumb Vehbi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik për zgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtari Suela Dashi.

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtari Suela Dashi.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Pëllumb Vehbi.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Pëllumb Vehbi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pesëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të për zgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë (Zëvendëskryetari) i kësaj të fundit dhe konkretisht: z. Erjon Çela.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik për zgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Enkelda Dalipi.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Erjon Çela.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Enkeleda Dalipi.

(Ripërsëritet shorti, pasi për zotin Erjon Çela është propozuar përjashtimi nga shorti).

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Sami Ujkashi.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Enkeleda Dalipi.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Sami Ujkashi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e kësaj çështje të përjashtohet kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, konkretisht: znj. Esmeralda Xhili (Çeka).

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Lorena Çabej.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që:

Në shortimin e kësaj çështje të përjashtohet Kryetari në detyrë (Zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, konkretisht: Z. Durim Hasa; Në shortimin e çështjes të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: znj. Adelajda Gjuzi, znj. Matilda Llangozi, z. Kostika Çobanaqi, znj. Lutfije Celami.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Kledja Çapja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e këtyre çështjeve gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 2.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë (zëvendëskryetarja) e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë konkretisht: znj. Luljeta Kole. Gjithashtu të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: z. Besnik Shehu, z. Maksim Qirjazi, z. Arben Lera dhe znj. Arjola Kristo.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe

kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Seladin Pysqyli.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Markelian Kuqo.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Civil të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilët janë caktuar më herët për gjykimin e çështjeve të veçanta në gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Znj. Klorinda Çela, Znj. Antonela Prendi, Znj. Enkela Bajo, Znj. Blerina Muça, Znj. Fida Osmani, Znj. Fatime Deçolli, Znj. Anila Capo (Zëre), Z. Arjan Aliaj, Znj. Anila Karanxha, Znj. Manjola Xhaxho, Z. Flamur Kapllani, Z. Altin Shkurti, Znj. Mimoza Kajo.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Arjana Gumbardhi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të njëzetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë administrative.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, konkretisht: z.Ramiz Lala.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Hazbi Balliu.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor